



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT - OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. -1-138

Data 23.10.2023

Br.

Datum

OBILIĆ

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.28.09.2023, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Labinot Mirena (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Valon Svirca (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic(SL).

Të pranishmit tjerë: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, drejtorët komunal, Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun, Burim Gërguri, shef i kabinetit të Kryetarit, Drita Hashani, zyrtare ligjore dhe Fazli Përvetica, zyrtar mjedisor

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit
4. Planifikimi i buxhetit për vitin 2024 dhe parashikimet për vitet 2025-2026
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 20 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 21 vota për.

Pika e 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga DMM-ja, për shqyrtimin dhe aprovimin e Planit lokal të veprimit për cilësi të ajrit.

Enver Gashi – Në si grup parlamentar jemi që ky Plan lokal i veprimit të kaloj në Kuvend, pasi i ka kaluar të gjitha proceset legale derisa ka ardhë këtu dhe ne në KPF, kemi qenë dakord që të vjen në Kuvend për aprovim.

Sami Ahmeti – Kryesuese, kërkoj mirëkuptimin e juaj sepse kanë kaluar 4,5 ditë nga vrasja e policit Afrim Bunjaku dhe propozoj që ne si kuvendarë ta mbajmë një minutë heshtje si shenjë nderimi për veprën e tij dhe vrasjen nga kriminelët e veriut.

Kryesuesja – Patjetër, z. Ahmeti ne kemi mbajtur edhe në KPF një minutë heshtje dhe kërkoj nga të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe të pranishmit tjerë të mbajmë një minutë heshtje.

Pas nderimit me një minut heshtje për policin e rënë në detyrë mbledhja vazhdoi.

Sami Ahmeti – Ne edhe në mbledhjen e KPF-së, e cekëm se nuk kemi ndonjë vërejtje lidhur me këtë dokument duke pasqyruar se edhe Ministria, ka vërtetue se është gjithçka në rregull dhe ne si grup jemi pro miratimit të këtij dokumenti.

Ajet Berisha – Unë sa munda me përcjellë sidomos kur bëhet fjalë te adresimi, apo tabelat e veprimeve që rrjedhin nga objektivat, paraqiten të gjitha problemet, paraqitet edhe buxheti që është mbi 6 milionë, por mendoj se adresimi që fajtorit ti mbuloj kryesisht dëmet që i shkakton, më duket se i mungon këtij plani. Në këtë aspekt mendoj se KEK-u, është dashtë me u ngarkue shumë më shumë në të gjitha pikat ku ka ndikim në cilësinë e ajrit. Për mua, kjo është një vërejtje, por pse jo edhe Ministria sepse dëmet që i ka shkaktue korporata janë kogja afatgjate dhe janë kogja të gjata në kohë, kështu që edhe Ministria e mjedisit dhe KEK-u, është dashur me qenë financuesit kryesor që ky plan i veprimit ndoshta, ta ketë edhe buxhetin pak më të madh për me arritë synime më të mëdha në këtë periudhë kohore. Po ashtu, kjo mbulueshmëri mos të preket edhe përkundër vullnetit të mirë tonin kur ne nuk jemi shkaktarë të kësaj gjendjeje, përveç aty ku jemi mendoj se ky buxhet i varfër i joni nuk është dashur me u prekë përveç si vullnet simbolik dhe këto synime me u mbulue përmes shkaktarit kryesor që është KEK-u dhe Ministria e mjedisit. Edhe një element krejtë formal kur bëhet fjalë te përshkrimi real dhe përputhja me dokumente, thotë bazohet edhe në profilin e planit zhvillimor komunal 2020-2028, nuk është ndërroni këto e të bëhemi pak më serioz sepse është periudha 21-31, apo sa e kemi tash planin zhvillimor, kështu që janë elemente të vogla ndërsa, për pjesën tjetër pajtohem.

Fazli Përvetica – Sa i përket projekteve që i ceku parafolësi ku është paraparë te projektet dhe donatorët që kanë me marrë pjesë në ato projekte, është paraparë me marrë pjesë edhe KEK-u, edhe Ministria mirëpo ne e kemi përgatitë për nivelin lokal dhe e kemi paraparë buxhetin në nivelin lokal. Ato janë kompetencat e nivelit qëndror dhe niveli qëndror duhet të merret me problemet dhe projektet në të cilat do të përfshihet edhe KEK-u.

Ajet Berisha – Është një rregullë dëmtuesi i paguan ato dëme dhe mendoj se vlera prej 6 milionëve, me përmirësimin e cilësisë së ajrit deri në vitin 2027 është e ulët, duke marrë për bazë shkaktarët se veç me i marrë filterat në Kosovën B, kushtojnë shumë më shumë. Mendoj se edhe pse nuk është kompetencë e jona, vlerësimi me koston e kësaj është dashtë me qenë më i madh dhe përgjegjësitë me iu lënë atyre që i kanë. Unë pajtohem se ne jemi nivel lokal, por vlerësimin është dashtë me bë pak më real në kuptimin e shkaktarëve të dëmeve, edhe si kosto. Unë e di se ne varemi vetëm prej buxhetit komunal, por përgjegjësitë me iu lënë secilit që e shkakton këtë dëm.

Fazli Përvetica – Ne jemi duke e punuar edhe Planin lokal të veprimit në mjedis dhe në plan jemi duke i përfshirë edhe këto probleme me KEK-un, që janë dhe për një kohë të shkurtë besoj se do ta punojmë këtë plan. Komisioni është i formuar dhe ne jemi duke e punuar Planin lokal të veprimit në mjedis.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 21 vota për morën Vendim për Arovimin e Planit lokal të veprimit për cilësi të ajrit.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën e DEFZH-së, për shqyrtimin dhe aprovimin e e planifikimit të buxhetit për vitin 2024 dhe parashikimet për vitet 2025-2026.

Enver Gashi – Mund të them se sot e kemi një pikë të rendit të ditës kulmore për zhvillimet një vjeçare të Komunës. Ky buxhet që na ka ardhë është prej më të mirëve dhe e përgëzoj Ekzekutivin. Unë në mbledhjen e KPF-së, e ceka se kemi arritë që shpenzimet kapitale me i tejkalue sasinë e mjeteve për paga dhe meditime. Po ashtu, është edhe një e dhënë tjetër që të hyrat vetanake të Komunës çdo vit si Kuvend i kemi rritë, që do të thotë se shihet puna e Ekzekutivit. Prandaj, ne si grup parlamentar jemi për atë që ky buxhet të aprovohet dhe uroj që në vitin tjetër të jetë edhe më i mirë.

Sami Ahmeti – Në fakt një buxhet që në shifra duket se mund të jetë në rregullë, por ndarje proporcionale me numër të banorëve duket që s'ka. Millosheva, ta zëmë si vendbanimi i dytë më i madh prej Obiliqit për vitin 2024 nuk ka asnjë investim, parashihet diçka në vitin 2025. Përveç, kësaj disa nga subjekti juaj politik nuk di cili me thënë nga fundviti i kaluar dolët me një kërkesë drejtuar Parlamentit të Republikës së Kosovës, që të marrim një buxhet shtesë për 5 projekte, të cilat nuk i keni përfshi në buxhetin e tanishëm. Do të thotë aq serioze, po duket se ka qenë kërkesa sa që ka qenë vetëm me bë pak skena. Në ndërkohë ku është ndërtimi i kopshtit të fëmijëve në fshatin Milloshevë, ndërtimi i rr."Ävni Rrustemi" Obiliq-Milloshevë, tani shtrirja e rrjetit të testimit të ngrohjes që ka qenë kontratë paraprake, mbjellja e drunjëve dekorativ, ndërtimi i urës automobilistike mbi lumin Drenica në Grabofc, rindërtimi i rrugës Obiliq-Fushë Kosovë, Krushevc-Nakaradë. Asnjë prej këtyre projekteve nuk janë, pyes pse nuk janë në buxhet. Duke pasë parasysh këto dhe nevojat e shumta të qytetarëve, përveç asaj ne para se ta mbajmë mbledhjen e KPF-së, ne e mbajmë edhe një takim me organizatën Demos, të cilët më shumë ishin të specializuar në fushën e buxheteve, edhe ata e thanë se të dhënat e dala nga debatet publike duhet të iu shpërndahen asambleistëve, kërkesat që kanë dalë nga debatet publike. Aty, u dakorduam kryesuese që Komisioni me i përcjellë ato kërkesa të debateve publike, që ne me kuptue a vërtetë, kanë hy ato kërkesa që kanë dalë prej debateve publike, apo debatet publike po mbahen sa për sy e faqe. Duke u nisë prej krejtë këtyre, ju thatë se e keni marrë krejtë materialin dhe është e vërtetë se e kemi marrë materialin final, por jo materialin që i ka parapri kësaj, që është dashur me na ardhë edhe materialet dhe kërkesat që kanë dale prej debateve publike, që të shohim se a janë të inkorporuara në buxhet, apo jo. Ne si grup jemi kundër këtij buxheti.

Ajet Berisha – Në thelb si buxhet krahasuar me nivelin e Komunave, që i takojmë mendoj se është buxhet kogja mirë i konsoliduar në kuptimin e të hyrave vetanake dhe burimeve tjera, që krijon mundësi për investime pak më proporcionale që po mungon. Pra, ka fshatra të tëra që 3 vjet, nuk parashihet asnjë investim, do të thotë është një dëm. Kjo, për një arsye se është një projekt i madh ndërtimi i ngrohjes qëndrore pädyshim që po, është një projekt me rëndësi të veçantë pädyshim që po. Mendoj se është dobësi e kësaj qeverisjeje që asnjë metelik nuk ka mund me nxjerrë për një projekt i cili ka me u marrë në Komunën e tij kryesisht e merrë nga fondet e Bankës zhvillimore, bankës evropiane në zhvillim, apo nga fondet tjera të cilat BE-ja dhe institucionet tjera, janë të gatshme me ofrue mjete për qëllime të tilla edhe mjedisore dhe zhvillimore. Mendoj se në këtë drejtim keni treguar një dobësi, vullneti jonë patjetër është që ky projekt me ecë, por në aq kohë të gjatë sa ka me u dashtë për me përfundue ky projekt vërtetë, elementet tjera, Komuna do të mbetet prapa për shkak se përafërsisht 5 milion për vit po shpenzohen për këtë dhe nuk kemi kapacitete me fitue donacion, së paku deri tash jo, deri në vitin 2026 kur është bërë ky planifikim. Pra, nuk ka diçka që është paraparë përveç kërkesave për donatorë. Mendoj se nuk është e mjaftueshme me ardhë si kërkesë me thënë se ne kemi me kërkue, por meqë deri tash nuk është fitue ne nuk kemi kapacitete me bë projekte të tilla dhe me fitue donacione të tilla. Kjo, është një vërejtje sepse po shihet pjesa tjetër që ka mangësi në investime për shkak se ky është projekt i madh që e merrë shumicën e mjeteve për investime kapitale.

Shaip Paloja – Mendoj se është një buxhet i mirë dhe gjithëpërfshirës dhe vërejtja ime është se ne kemi pasë një takim më heret rreth buxhetit. Në atë takim kemi pasë edhe disa propozime për disa projekte, së paku unë disa që i kam propozue nuk po shohë se janë te infrastruktura. Eshtë me rëndësi sidomos projekti i oborrit të shkollës në fshatin Palaj, është shumë keq dhe nuk e pashë se është përfshirë. Sa i përket fjalimit të kolegut të LVV-së, për 5 projektet e Komunës së Obiliqit me të gjithë e dimë se ato kanë qenë

amandamente të propozuara nga deputetja e LDK-së, në Kuvendin e Kosovës, që të futen në buxhetin e vitit 2023 për investim në Komunën tonë dhe sikur ti kishte votue LVV-ja, ne sot do ti kishim pasë ato dhe do të ishin zbatue, por nuk kanë kalue në Kuvendin e Kosovës. Prandaj, ai propozim i Komunës së Obiliqit, nuk ka kalue sepse nuk është votuar nga subjekti i LVV-së.

Kryetari –Sa i përket qerdhes, me siguri keni informata edhe ju që është përfitue si donacion prej Ministrisë së Arsimit dhe për këtë nuk është pjesë e këtij projekti. Edhe shumë projekte tjera ka që i kemi i ndarë duke marrë parasysh se Komuna jonë do të jetë prapë përfituese sa i përket qështjes së performancës. Në performancë do ti kemi dikund prapë mbi 700,000 euro, që kemi menduar se në pjesën e projekteve të shkollës që e përmendi z.Shaip, e projekte të tjera të infrastrukturës me i përfshi me ato të hyra. Nuk është e vërtetë se nuk kemi bërë kërkesë sa i përket nxemjes qëndrore, me siguri e keni parë edhe një memorandum që e kemi nënshkrue me Komunën e Prishtinës. Eshë bërë studimi i karbonit në kyqjen e Obiliqit, që e ka bërë BE-ja, që është projekt i përbashkë me Termokosin dhe do të ndahet ndarje e veqantë për Obiliqin, një kyqje e veqantë e cila do ta ketë koston mbi 3 milionë. Pastaj, është projekti tjetër ku janë të përfshira 8 Komuna të Kosovës për nxemjen qëndrore dhe në këtë rast Komuna jonë është pjesë përbërëse e këtij projekti. Mund të them se jemi Komuna e vetme që kemi startue me implementimin e projektit dhe nga ky projekt pritet shuma në 3 vitet e ardhshme që do të jetë bartja e ujit të nxehtë nga nënstacioni deri te stacioni qendër dhe vlera e tij do të jetë dikund rreth 5 milionë. Gjithashtu, është zotue Prishtina në këtë rast që nëse, nuk i mbulon BE-ja, si projekt ose vonohet në afatin 3 vjeçar do ta mbulon Komuna e Prishtinës. Ne kemi aplikue edhe në institucione të tjera, ju e dini por fatkeqësisht qështja e donatorëve është pothuajse e përmbyllur derisa nuk bëhet zhblllokimi i masave të cilat janë aplikue në vendin tonë. Mbi të gjitha, ne jemi në kontakt me të gjithë donatorët dhe kemi bërë kërkesë edhe në organizatat tjera buxhetore, kështu që presim që në momentin e zhblllokimit të jemi përfitues.

Sami Ahmeti – Kryetari tha se qerdhja është donacion i Ministrisë, me qka pajtohem se është shumë e vërtetë, por mua vetëm më intereson me ditë se a është caktuar hapësira sepse edhe më heret ka pasë donacione dhe më heret ka pasë buxhete të ndara për atë qështje. Mirëpo, për shkak të hapësirës se ku do të ndërtohet, me mirëkuptim po e kërkoj këtë informacion a është caktuar nga Komuna sepse Komuna është e obliguar me gjetë hapësirën se ku ajo do të ndërtohet.

Kryetari – Edhe në vitin e kaluar 2022, Komuna ka aplikue dhe vendi është në Milloshevë, prapa Shtëpisë së shëndetit. Në aspektin administrativ të gjitha kërkesat që kanë qenë edhe qështja e pronës, qështja e kyqjes të ujit dhe aplikimi për leje, e di që Drejtoria këto i ka krye dhe i ka dorëzue në Ministri. Po ashtu, e di se edhe në Ministri jemi përzgjedhë për ndërtim dhe shpresojmë të fillojnë edhe më heret ndërtimet, por meqë Ministria e udhëheqë qështjen e Prokurimit shpresojmë që sa më shpejtë që është e mundur të filloj si projekt.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 13 vota për, 4 vota kundër dhe 4 vota abstenim morën Vendim për Arovimin e planifikimit të buxhetit për vitin 2024 dhe parashikimet për vitet 2025-2026.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja - I njoftoi të pranishmit me shkresën nga Ministria e financave, punës dhe transfereve lidhur me vendimin nr.-I-120, për lejimin e faljes së tatimit në pronë. Falja e tatimit në pronë është pezulluar dhe Gjykata kushtetuese ka marrë vendim për vendosjen e masës së përkohshme deri me 30 nëntor. Ky pezullim i vendosur nga Gjykata kushtetuese vlen vetëm për nenin 5 të tatimit në pronë për vitin tatimor 2023 të Ligjit nr.08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme. Ndërsa, dispozitat tjera të Ligjit nr.08/L-224 vazhdojnë të zbatohen.

Të nderuar, anëtarë të Kuvendit Komunal. asnjë vendim që merret në Kuvend nuk dërgohet në Drejtorinë përkatëse, për zbatim pa konfirmim të ligjshmërisë dhe ky vendim është pezulluar. Pra, ne nuk e zbatojmë këtë vendim derisa të merret një vendim përfundimtar dhe deri atëherë ju do të njoftoheni.

Ne në KPF e kemi shqyrtuar edhe kërkesën nga Kreshnik Balaj, Shkabaj sh.p.k. për zgjidhjen e problemit të pronësisë, që të gjendet një mirëkuptim i përbashkët për kthimin e pronave, qoftë në tërësi, apo ato pjesore derisa të përmbushet sipërfaqja totale prej 144,286 m². Z. Enver Gashi, ka kërkuar nga Drejtoria dhe zyra ligjore, që të vijmë me një sqarim në Kuvend sepse kjo është hera e dytë që e kemi trajtuar këtë kërkesë, ka ardhë me dt.12.05, që e kemi trajtuar në KPF, i kemi rekomandimet dhe procesverbalin.

Drita Hashani – Sipas kërkesës së KPF-së, zyra ligjore është munduar që ta përmbledhë një historik të lëndës, që është duke vazhduar ende në një proces gjyqësor. Ministria e bujqësisë pylltarisë dhe zhvillimit rural me një vendim të dt.25.08.2009 ka formuar Komisionin prej 6 anëtarëve për rregullimin e tokës në Komunën e Obiliqit, me Kryetar Osman Stulqaku. Pas përfundimit të punës së Komisionit, Kuvendi Komunal i Komunës së Obiliqit ka nxjerrë aktvendim mbi ndarjen e tokës nga masa e komasacionit me nr.10955363, të dt.22.02.2011, ku pjesëmarrës në këtë komasacion ishte paraparë të jetë edhe Ndërmarrja e re Tokat bujqësore-Shkabaj. Me dt.12.04.2011, përmes ankesës me nr.694, Shkabaj sh.p.k kishte ushtruar ankesë kundër vendimit të Komisionit për komasacion të Kuvendit Komunal të Komunës së Obiliqit, Zona kadastrale në Mazgit nr.10 në Ministrinë e bujqësisë dhe zhvillimit rural duke kërkuar kthimin e tokave të cilat po i mungonin në terren. Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural me dt.01.07, do të thotë gati 6 muaj pasi që ka përfundue procesi e kishte aprovuar ankesën si të bazuar dhe kishte shfuqizuar vendimin e Komisionit për komasacion të Kuvendit Komunal të Obiliqit, zona kadastrale Mazgit të vitit 2011. Po ashtu, bashkëpronari i Shkabajve Sh.p.k Besim Elshani, lidhur me mungesën e parcelave dhe tjetërsimin e parcelave në sipërfaqe prej 14 ha e 42 ari e 86 m² ku pronat kishim kaluar te personat e tretë dhe dëmi i shkaktuar i të dëmtuarit sipas ekspertizës financiare është mbi 620,000 euro. Sipas çmimit të vlerës nga AKP-ja, ishte ankuar edhe në Policinë e Kosovës, Departamenti për krime ekonomike. Me dt.28.12.2017 Prokuroria themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda pas zhvillimit të hetimeve kishte ngritur aktakuzë kundër Kryetarit të Komisionit për komasacion z.Osman Stulqakut, për veprën penale keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar. Po ashtu, Gjykata themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda kishte shpallur aktgjykimin refuzues kundër z.Osman Stulqakut për shkak të parashkrimit të lëndës penale ndaj të akuzuarit. Ndërsa, në pikën 5 të këtij aktgjykimi pala e dëmtuar Besim Elshani në bazë të nenit 463 kishte të drejtë në kërkesën pasurore juridike në kontestin civil juridik dhe tash këtu, jemi ne. Bazuar në këtë Ndërmarrja Shkabaj Sh.p.k. ka paditur Republikën e Kosovës, Qeverinë e Kosovës dhe Komunën e Obiliqit, për vërtetimin e pronësisë me kërkesë për kthimin e të njejtës, ose kundërvlerës me para me propozim të masës së sigurisë në vlerën prej 600,000 euro. Në këtë çështje kontestimore Komuna e Obiliqit pas marrjes së padisë dhe propozimit të masës së sigurisë ka pranuar aktvendimin C.nr.1268/2021, ku brenda afatit ligjor ka dhënë përgjegje lidhur me masën e sigurisë duke u bazuar në deklaratimet, provat që i ka poseduar DPUPK-ja, dhe i ka dorëzuar në Zyren ligjore për përgjegje në Gjykatë: Gjykata themelore në Prishtinë, Departamenti i përgjithshëm ka mbajtur disa herë seanca lidhur me masën e sigurisë të propozuara nga paditësi Shkabaj Sh.p.k. dhe po ashtu, me kërkesën e palës ka dalë në vend shikim në terren me ekspertin e Gjykatës për konstatimin e gjendjes fizike të pronave dhe çështja është në procedurë e tutje. Deri më tash nga Gjykata ende nuk kemi pranuar ekspertizë nga terreni dhe Gjykata deri më tani nuk ka nxjerrë ndonjë vendim lidhur me masën e sigurisë. Në lëndë janë të gjitha provat që i ka drejtue DPUKP-ja. Çështja është shumë delikate.

Enver Gashi – Pyeti çka mund të bëjmë ne tash si anëtarë të Kuvendit Komunal.

Drita Hashani – Meqë, jemi të paditur edhe ne, edhe Ministria unë nuk e shohë të kundërligjshme me formue një grup punues me i parapri bisedimeve, me thirrë edhe kompaninë me pa deri ku është çështja. Përndryshe, lënda është në Gjykatë.

Ajet Berisha – Unë kam qenë edhe një herë në proces të kësaj lënde dhe përafërsisht jam i njoftuar me kaq sa e tha zyrtarja ligjore. Komisioni është themeluar nga Ministria e bujqësisë dhe i ka raportue Ministrisë së bujqësisë. Ai vendim i këtij Komisioni ka pasqyruar në dokumentet kadastrale te na, është bërë bartja dhe tash pas 5,6 muajve, ose një viti po iu bjen në mend atyre qysh ne me tërheqë vendimin,

ose pasqyrimin e punës së Komisionit sepse ka pasë një afat. Tash, këtu u bë dhe atje janë ankue, do të thotë pse ne me i bartë këto pasoja kur direkt është e lidhur Ministria e bujqësisë, pse nuk e merrë përgjegjësinë Ministria, pse e ka lënë kohën, apo është problem se Komuna e Obiliqit, është ngutë me bartje. Nëse, është konstatue se ne jemi ngutë me bartje, do të thotë e marrim pak përgjegjësinë, por kryesisht Ministria e bujqësisë është dashtë me i bartë pasojat për Komisionet që i bën dhe për raportet që ka krijuar ai Komision. Në bazë të asaj që e tha zyrtarja ligjore u kuptua se Komisioni është bërë prej Ministrisë, e ka bërë një punë dhe puna është pasqyruar në dokumentet kadastrale. Pas një kohe ai është ankuar, e ka fitue te Ministria dhe le te bartë Ministria këtë përgjegjësi.

Kryetari – Sinqerisht, së pari mua më vjen keq pse ka ndodhë si çështje, një problem mjaft serioz në pjesën e komasacionit komplet ndarja që ka ndodhë. Fatkeqësia më e madhe është se gjendja faktike ndryshon me atë të gjendjes kadastrale. Ne e dijmë se edhe Ministria dhe Komuna, në atë kohë e kanë pasë një Komision të përbashkët i cili daton tash në bazë të gjendjes faktike ndërrimi i parcelave dhe problemet që janë shkaktue, është mjaft një hapësirë e madhe sepse nuk po flitet për 4 ari, por për 14 ha. Prona gjendet në territorin e Komunës tonë pavarësisht që ka qenë Komisioni i Ministrisë, unë besoj se pasojat do ti bartim ne. Unë sugjeroj të formohet një Komision i përbashkët nga Kuvendi, Ekzekutivi dhe Zyra ligjore dhe nëse, është nevoja me angazhue edhe avokatin me qëllim që me shtjellue si çështje. Kjo, për faktin se ne e kemi pasë një rast me Rendën, kur vjen vendimi i formës së prerë ndoshta mund të ketë pasoja të jashtëzakonshme Komuna nëse, ka me ardhë një situatë me gjendjen faktike me ia pague 14 ha do të jetë mjaft një problem i madh. Prandaj, është mirë të formohet Komisioni, që me zgjidhë problemin, me shikue edhe çështjen se ku është nëpër procedura gjyqësore, me shqyrtue çështjen edhe me kompaninë, që nëse Komuna dëmtohet në këtë rast, ose delë fajtores me pa ndonjë alternativë tjetër të kompensimit të asaj hapësire. Mendoj se nëse, mbetet si çështja e Rendës, kur vjen vendimi gjyqësor ne duhet ti bartim pasojat.

Kryesuesja – Është edhe shkresa e Drejtorisë me nr.-V-1185 e dt.26.09.2023, që pas rekomandimit të KPF-së, e ka shpjegue dhe materialin e keni. Në fund ka kërkuar që të formohet një Komision nga Kuvendi dhe Ekzekutivi për shkak të ndjeshmërisë së lëndës.

Sami Ahmeti – Në lidhje me temën Komuna e Obiliqit, do të thotë Ekzekutivi i ka të gjitha mekanizmat me funksionue ndoshta, edhe pa e involvue Kuvendin vetëm me informue Kuvendin, për faktin se kur po ka çështje që duhet me mbulue qoftë gabimin apo diçka tjetër, po involvohet Kuvendi. Unë e them shumë me sinqeritetin më të madh cili prej kuvendarëve e ka ekspertizën e duhur që me u marrë me atë fushë, apo me ato çështje, Asnjë prej neve, nuk mundemi me marrë përsipër një diçka që me vendosë kështu, apo ashtu. Komuna e Obiliqit, e ka një zyrë ligjore, Komuna e Obiliqit e ka një marrëveshje me një shumë të majme me një avokat të Komunës, i cili i mbron këto çështje. Ne si Kuvend, mundemi që çdo Komision që ja e propozoni të Ekzekutivit, me ia dhënë mundësinë, por jo me involvue Kuvendin sepse shumë herë asambleistët po involvohen në disa tema, që as vetë nuk e dijnë se për çka janë. Unë konsideroj se është temë e ndijshme, mos e dhashtë zoti me iu shkaktue ai dëm buxhetit të Komunës, bashkëndjej edhe me Ekzekutivin sepse është problem gjithë ato mjete me shkue poshtë, ose gjithë ajo hapësirë nesër me ardhë puna me kompensue. Mirëpo, kur Ekzekutivi i ka krejtë mekanizmat, ne ia japim fuqinë le të veprojnë, por jo me u mundue me na involvue neve, në atë aspektin hajt veç të mbulohe mi dhe nesër të fshehemi pas votës së Kuvendit.

Kryetari – Tash, nuk due me i akuzue se edhe atëherë kur ka ndodhë komasacioni, nuk dua të them se edhe ata e kanë pasë qëllimin e keq, por situata ka ardhë ku ka ardhë. Te çështja e Komisionit për negocijim, unë sa e di të drejtë ka Kuvendi dhe tash a e formojmë bashkë, apo vetëm prej Kuvendit meqë është trajtim i pronës, ose vetëm prej Ekzekutivit, cilido qoftë ai Komision duhet me marrë një miratim prej Kuvendit.

Fidan Ahmeti – Pyeti Komisioni i cili formohet a do të jetë vetëm për këto parcela apo edhe për tjerat sepse shumica e Mazgitit, që është në atë zonë kadastrale e kanë të njëjtin problem. Unë kam edhe pjesë të familjes që janë në procedura të Gjykatave dhe nuk kanë mund me bë zgjidhje. Pra, ky Komision a

formohet për të gjithë apo vetëm për problemin që e kemi sepse realisht edhe atje ka probleme se nesër do të qfaqen prapë.

Ajet Berisha – Unë e kam lexue edhe kërkesën e palës dhe përgjegjen e DPUKP-së. Kërkesa është që ne me bë një Komision, që me negociju me palën për një marrëveshje eventuale, që mos me vazhdue procedura gjyqësore. Në rast se kjo është një mundësi e cila e përmbyllë më lirë, kushton më lirë kishte me qenë më mirë, por unë qysh e dëgjova zyrtaren ligjore përgjegjësia është e Ministrisë së bujqësisë, po insistoj këtu pa marrë ndonjë shpjegim adekuat. Në rast se përgjegjësia është e Ministrisë së bujqësisë, le të negocijon ajo për pasojat, e jo ne me një diçka që nuk është faji ynë. Unë vetëm këtu e kam problemin, ndërsa pjesën tjetër duhet me trajtue si nikoqir, si i zoti i shtëpisë secili prej neve, që me kalue me sa më pak pasoja në rast se kemi përgjegjësi. Pra, në rast se unë e kuptova zyrtaren ligjore, ne përveç asaj bartje që ka ndodhë në bazë të një vendimi të një Komisioni të formuar nga Ministria, ne pjesën tjetër nuk kemi ndonjë faj, ose ne po ulemi dhe po e kompensojmë palën për 14 ha të munguar, por kush i ka marrë ata 14 ha. Në rast se ne e kompensojmë dhe e kemi marrëveshjen, atëherë pse mos me i marrë ne ata 14 ha, po i paguajmë dhe po i marrim ne dhe ky është një negocijim edhe i mirë. Në rast se ne negocijojmë, e paguajmë dhe nuk i marrim ata 14 ha, atëherë pse me pague ne. Është njëfarë logjike në veprim që ne gabimin tonë po duhet me marrë krejtë vetëm pse është bërë bartja e një pune të një Ministrie, jo merre ti përgjegjësinë. Në rast se ne i marrim ata 14 ha atëhetë kemi bashkëllogaritje edhe paguajmë dhe e marrim përsipër gabimin e një Komisioni, por atë pronë e marrim ne si Komunë. Ndryshe, nuk mund ta kuptoj pse duhet ne të involvohemi.

Kryetari – Është e vërtetë se Komisionin më duket Ministria e ka formue, por Komisioni ka qenë i përbërë prej Komune, me anëtarë nga Komuna. Mendoj se asnjë e keqe nuk ka që një Komision me formue dhe me trajtue së pari lëndën se qysh ka ardhë deri aty. Pastaj, çdo veprim të Komisionit para marrjes së vendimit është mirë me diskutue qoftë i Ekzekutivit me Kuvendin, apo i Kuvendit me Ekzekutivin. Unë kisha me thënë shikone mirë lëndën, ai ka dokumentacion që kur ka fillue komasacioni, ai ka thënë unë nuk e ndaj parcelën time se i kam 60 ha, apo sa i kishte pasë. Mirëpo, fati tash në fatkeqësi këto, kanë qenë shtëpi të ndërtuara prej banorëve, që i kanë shfrytëzue më heret dhe ku me ditë sa kohë i kanë shfrytëzue.

Ajet Berisha – Pyeti në bazë të ligjeve dhe dokumenteve që janë a ka gjasa me dalë humbës.

Drita Hashani – Përgjegjet nuk mund ta di sepse lënda është në Gjykatë.

Kryesuesja – Z.Berisha, po kërkon dhe thotë se është formuar një Komision nga Ministria, por anëtarët e Komisionit kanë qenë banorë, apo zyrtarë të Komunës së Obiliqit, të cilët i kanë dërgue të dhënat në Ministri dhe Ministria, ka vendosë në bazë të të dhënave të tyre.

Drita Hashani – Sqaron se ka pasë edhe banorë të Obiliqit edhe zyrtarë komunal.

Arben Berisha – Së pari kërkesën që e kam bërë ka rrjedhë gabim sepse duhet me qenë rekomandim. Komasacioni është ruajtja e tokave dhe rregullimi i parcelave, të cilat në bazë të klasës i ka takue nëse, iu ka marrë psh 1 ha e klasës së parë atëherë, iu ka ka kthye pak më shumë se 1 ha e klasës së dytë. Ne e kemi një praktikë të keqe, që na ka ndodhë që i kemi pague mbi 300,000 euro, ia kemi lënë kohës dhe Gjykata ka vendosë gati 400,000 euro vlera. Tash ne kemi të bëjmë me pronën që iu ka marrë dhe Komisioni i komasacionit është i përbashkët Ministri-Komunë dhe Ministria, kur e ka pa se çka ka ndodhë kur pala ka kërkuar mos ma merrni tokën se nuk jam i interesuar me bë riorganizim të pronës sepse e kam krejtë në parcelën time. Ministria e ka bërë një shkresë dhe e ka tërheqë Komisionin e vet me vonesë, por është dashur me shfuqizue edhe nga ana e Komunës. Unë i kam pasë edhe krimet e rënda, prokurorin e rastit dhe gjykatësin, është ngritë padia për anëtarët e Komisionit, por për shkak të vjetërsisë së lëndës është hedhë poshtë. Ne kemi bë një lloj rekomandimi që me u implikue dhe ju për arsye se pronari i tokave është Kuvendi, e jo Ekzekutivi. Nëse, ne mund të gjejmë një marrëveshje të mirë edhe Gjykata, e njëhë marrëveshjen mundemi me pezullue komplet situatën. Unë nuk e di sa i keni kushtue vëmendje shkresës së pronarit, në fund te vërejtja thotë: “Gjykatës kompetente që do të kërkojmë fitimin e humbur për 14 ha për sa vite si dhe

çmimin e tregut që ndoshta kjo është pak kërcënuese, por realiteti mundet me na ndodhë edhe kështu. Nëse, ne nuk merremi hiç me këtë çështje dhe na vjen qysh na ka ardhë sipas praktikës së mëhershme, besoj se kushdo që vjen edhe ne do të ndjehemi keq pse nuk jemi marrë me lëndën. Ne mund ta trajtojmë së bashku këtë lëndë dhe ne nuk po fshehim asgjë sepse lëndën e kemi gjetë prej vitit 2011, ndërsa në vitin 2009 e ka privatizue ai që s'ka guxue të bëhet kjo, por tash u bë dhe gjendja është kësisoji. Ne kemi dokumentacion se edhe Gjykata, është ra në telashe me këtë lëndë, që nuk din çka me bë. Prandaj, meqë e kemi këtë vakum ulemi së bashku dhe e trajtojmë lëndën. Ishte një pyetje më heret dhe ju sqaroj se lëndët tjera, nuk trajtohen. Ne jemi munduar atje, me bë zgjidhje, por njërit prej tyre i ka ardhë vendimi i Gjykatës, që ia njuhë kufijtë e vet dhe ne si Drejtori nuk kemi guxue me bë marrëveshje, Nëse, ai na kishte lejuar ne kemi dashtë me bë marrëveshjen dhe krejtë janë 5 m² që nuk e kanë lejuar me zgjidhë problemin. Unë i kam pri situatës, e kam marrë rolin sepse marrëveshjen e njuhë edhe Gjykata, kështu që i kam mbledhë, i kam lutë merrnu vesh e unë po bëjë ndërhyrje. Mirëpo, njëri prej tyre, që mua më ka ardhë keq nuk ka dashtë me bë se po i humbë 5 metra, 2, ose 3 m² kështu diçka ka qenë.

Valon Svirca – Prapë kanë bërë ankesë për Gjykatë sepse ashtu ka qenë siç po thua ti për me u zgjidhë problemi, por njëri prej fqinjëve nuk ka pranue.

Shaip Paloja – Mua, më intereson këta 14 ha tokë a është dikush duke i shfrytëzue dhe ne nëse, arrijmë kompromis me pronarin a do të kemi edhe me ndonjë palë tjetër telashe në të ardhmen.

Arben Berisha – Unë nuk e di sa isha i qartë se si ka rrjedhë problemi, iu kanë marrë këtu dhe iu kanë dhënë aty, ndërsa pala e tretë e gëzon autoritetin, e ka parcelën dhe ne nuk kemi të bëjmë me palën e tretë. Ne kemi të bëjmë me palën që po e konteston, ka bë padi dhe po kërkon prapë me u marrë vesh sepse e ka sqarue shumë mirë se investimet i parashehë në parcelat e veta dhe i ka bukur të mëdha. Në kuadër të kësaj unë si drejtor kisha kërkuar dhe kisha rekomandue me bë një Komision të përbashkët me trajtue lëndën, por të paktën si për praktikën e mëhershme, mëkat është që nuk kemi bë një marrëveshje me të. Më mirë kishte me qenë sikur te kishim ndalë në 80,000 ose 100,000 euro, dhe tash e kemi pasë 400,000 që e kemi paguar në vitin e kaluar.

Labinot Mirena – Unë ia kisha lënë Gjykatës me vendos sepse prej vitit 2009-2011 e tutje, po i bjen gati 10 vjet që është lënda dhe sipas zyrtares ligjore as Gjykata nuk din se çfarë të bëjë me lëndën, e ishalla nuk din kurrë dhe e shfrytëzojnë ata banorë që janë atje, e gëzofshin. Ata që i kanë bërë këto veprime ndoshta, Gjykata e paska lënë qëllimshëm me u vjetërsue lënda dhe ata me u shfajësue të gjithë. Prandaj, ia kisha lënë këtë çështje Gjykatës, që edhe pas 10 vjete, kur të vendos e përfundon edhe me Ministrinë çështjen.

Enver Gashi – Propozoj që të formohet një grup punues, por përbërja e tij mos të jetë vetëm nga Kuvendi, ose vetëm nga Ekzekutivi. Për neve, kuvendarët kishte me qenë më së miri që grupi punues të përbëhet vetëm prej Ekzekutivit, por ja që po kërkohet ndryshe dhe ne po i ndihmojmë në këtë drejtim. Mendoj se ky grup punues nuk do të jetë vendimtar sepse kanë me qenë edhe proceset tjera, ka me u shqyrtue edhe në Drejtorinë përkatëse dhe prapë ka me ardhë këtu, në Kuvend. Është mirë me negociju edhe nëse, na delë një rezultat 00, sepse prej praktikave të mëhershme e dimë se kështu duke e neglizhue Rendën e kemi paguar dhjetëfish, që sikur të kishim tentue ndoshta, diçka kishte me shpëtue.

Sami Ahmeti – Duke u bazuar në kërkesën e personit në fjalë, ajo nuk është në njëfarë mënyre kërkesë, por është një lloj kërcënimi për me bë pazar, a po bëjmë kështu, apo unë ua bëjë kështu. Edhe në njëfarë mënyre kur Gjykata është e Republikës së Kosovës, Gjykata është e jona nuk është që vendosin edhe ata veç prej një orientimi sepse nuk ka qenë vetëm Komuna e Obiliqit e involvuar këtu, por kanë qenë edhe Ministritë. Unë e thashë prapë me dashtë me ia dhënë edhe njëherë Ekzekutivit votën, po mblihdhemi si Kuvend dhe po i tregojmë se i ka krejtë kompetencat. Unë e di se Kuvendi është organi më i lartë, por Drejtoria në fjalë dhe institucioni në fjalë i ka krejtë mekanizmat dhe vetëm mundet me ardhë dhe me na informue neve, se qysh ka ardhë gjendja deri këtu. Ne po e kuptojmë se nuk ka qenë përgjegjësi e kësaj, apo asaj qeverisjeje dhe nuk është problem ajo se kush është, por edhe drejtori tha se edhe 8 vjet janë këtu, le ta rregullojnë pasi veç janë, i dijnë gjërat le ti kryejnë vetë. Mirëpo, mos të mundohen me shtie

se vetë tha e kemi pasë Prokurorinë këtu, dhe kemi provue për ta vënë para përgjegjësisë dhe tash, vendose ti kuvendarin para përgjegjësisë për çështje të cilat nuk i takojnë. Ne jemi për me na informue dhe me i dhënë orientimet tona, por jo me marrë vendime. Ne si grup nuk jemi për këtë formë të Komisionit, e thashë nëse, kanë nevojë ne prapë ua japim pëlqimin dhe ju tregojmë edhe një herë që edhe pa votën tonë i keni kompetencat sepse e keni qeverisjen, i keni Drejtorinë, e keni zyren ligjore, e keni avokatin e Komunës, i cili paguhet me para të majme dhe nuk bën asgjë, kështu që shihni.

Kryetari – Ne jemi të gatshëm me marrë përgjegjësi për me trajtue lëndën, por autoritetin duhet me dhënë ju. Nëse, ju e formoni një Komision dhe e votoni, unë besoj se në aspektin ligjor duhet të jetë në rregull dhe le të vazhdon punën zyra ligjore me DPUKP-në. Po ashtu, mund ta kemi një ditë pune me shefat e grupeve, le të shikojnë lëndën komplet dhe mendoj se Komisioni nuk do ta ketë atë të drejtë me marrë ndonjë vendim pa e marrë aprovimin prej Kuvendit. Sido qoftë si çështje duhet me trajtue nëse, gjejmë mundësi mirëkuptimi.

Enver Gashi – Nëse, i mbetet Ekzekutivit atëherë Ekzekutivi e formon Komisionin dhe emrat na i sjellë në Kuvend. Nëse, Komisioni bëhet mix atëherë kërkojmë pauzë. Në fillim duhet ta dijmë se a po bëhet Komisioni mix apo po ia japim autorizimin Ekzekutivit, zyres ligjore dhe Drejtorisë së caktuar.

Kryesuesja – Se a do të bëhet Komisioni mix, apo jo varet prej anëtarëve të Kuvendit sepse ju e votoni.

Arben Berisha – Rekomandimi i Drejtorisë në këtë aspekt dhe i Ekzekutivit është që Komisioni të jetë mix, për arsye që çdo finale që vjen ju me qenë në ngjarje dhe me qenë në rrethana të njoftimit për lëndën se çka ka me u bë. Rekomandimi ynë është që Komisioni me qenë mix dhe këtu kemi me pasë edhe zyren ligjore, kemi me pasë edhe avokatin, Kryetarin, Kryesuesja dhe në fund do të jeni të gjithë. Çështja nuk është vetëm me tejkalue, por çështja është me zgjidhë diçka nëse, mundemi me bë.

Drita Hashani – Unë nuk e konsideroj se është kundërligjore me formue një Komision për me trajtue çështjen.

Pas një pauze prej 10 minutave mbledhja vazhdon.

Enver Gashi – Ne veç ishim në këtë pauzë dhe e shfrytëzuam që të merremi vesh për formimin e grupit punues dhe ne u dakorduam që ky grup të jetë prej Ekzekutivit sepse ka njerëz profesional dhe është zyra ligjore. Ne si anëtarë të Kuvendit mundemi me ia dhënë mandatin Ekzekutivit, që ta formoj këtë Komision. Ekzekutivi mundet me na dhënë edhe numrin e anëtarëve, ne e votojmë dhe sigurisht se pas një kohe është mirë me raportue në Kuvend.

Sami Ahmeti – Ne e mbështesim Komisionin që formohet prej Ekzekutivit sepse e kanë detyrë dhe ne ia japim votën, do të thotë jemi pro.

Kryetari – Propozon nga Ekzekutivi anëtarët e Komisionit: Arben Berisha, Naim Miftari, Bejtullah Mjekiqi; Abdyrrahman Krasniqi dhe Drita Hashani, zyrtare ligjore.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 17 vota për dhe 2 vota abstenim morën Vendim për themelimin e Grupit punues, i cili do të shqyrtoj kërkesën e Ndërmarrjes “Shkabaj” SH.P.K. me këtë përbërje:

1. Arben Berisha, Kryetar (Drejtor i DPUKP)
2. Naim Miftari, anëtar (Drejtor i Inspeksionit)
3. Bejtullah Mjekiqi, anëtar (Drejtor i DBZHR)
4. Abdyrrahman Krasniqi, anëtar (Drejtor i DSHPE)
5. Drita Hashani, anëtare (Zyrtare ligjore)

Kryesuesja – Ju njoftoj se kërkesa nga Eljesa Terbunja, më është dorëzuar tani, por për shkak që mos të kalojnë afatet ligjore do ta paraqesë. Sipas kërkesës për vitin 2024 është paraparë me iu nda 12,000 euro, për vitin 2025 me iu nda 12,000 euro dhe për vitin 2026 po ashtu 12,000 euro. Unë kam qenë edhe drejtoreshë e DSHMS-së, por OJQ-të, e tilla subvenciohen përmes thirrjeve publike. Kjo kërkesë me 20 vota për i rekomandohet DEFZH-së dhe DSHMS-së për shqyrtim.

Kryesuesja – Po ashtu, e kemi trajtuar edhe në KPF, ka qenë Komisioni për monitorimin dhe realizimin e kontratave të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme komunale dhe ky Komision ka hartuar raportin 6 mujor 2023. Në mbledhjen e gushtit 2023 të Kuvendit Komunal është kërkuar raport i veçantë për secilën kompani dhe më i detajuar përkundër se për të gjithë operatorët është nda raporti lidhur me ecurinë e kontratës. Andaj, Komisioni me mirëkuptim raportimin e radhës, do ta ketë në dhjetor 2023, eventualisht në janar 2024.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Z.Enver Gashi, ka kërkuar nga Komisioni i formuar për shqyrtimin e parcelave të shpronësuara të fshatit Siboc, me njoftue Kuvendin se deri ku ka arritë me punën.

Jeton Mjekiqi – Në cilësinë e Kryetarit të Komisionit për evidentimin e shpronësimit të banorëve të fshatit Siboc, konkretisht të lagjes “Mexhuani” dhe “Konxheli” duke u bazuar në vendimin e dt.31.07.2023, ju njoftoj se Komisioni gjatë kësaj kohe ka punuar intenzivisht, ka shqyrtuar disa dosje të banorëve se si është vlerësuar prona e tyre dhe jemi duke vazhduar punën në takimet e drejtëpërdrejta me palët e përfshira në proces. Gjatë kësaj kohe kemi tentuar vazhdimisht takim me Ministrinë e financave, përkatësisht me Departamentin për shpronësim, por duke pasë parasysh se kanë qenë pushimet verore dhe angazhimet e tyre, ka qenë e pamundur deri me dt.27.09.2023. Me këtë datë jemi takuar në Departamentin e shpronësimit, përkatësisht me zyrtarët e këtij Departamenti dhe në këtë takim kemi qenë prezentë unë, Jeton Mjekiqi dhe z.Sami Ahmeti. Në këtë takim jemi njoftuar me procedurat të cilat janë zhvilluar si dhe nga i njejtë Departament ku është theksuar se të njejtë kanë vepruar në bazë të një vendimi të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.17/136, të dt.22.03.2023, duke u bazuar në kërkesën e KEK-ut. Kjo, do të thotë se KEK-u, ia ka bërë Qeverisë këtë kërkesë me bë shpronësimin me këtë Ligj të shpronësimit, me të njejtën të cilën e ka aprovuar Ministria dhe Qeveria. Ne kemi planifikuar që gjatë muajit tetor ti kemi edhe disa takime të tjera, në kuadër të grupit punues, që kemi kërkuar edhe me KEK-un, por ka qenë e pamundur deri sot që e ka konfirmue se mund të shkojmë në takim, por ende nuk e kam njoftue grupin. Po ashtu, ju njoftojmë se banorët tashmë veç e kanë fillue procedurën gjyqësore sepse seancat e para janë mbajtur me dt.26.09.2023. Ne jemi në kontakt edhe me avokatin e banorëve, i cili ka kërkuar në lëndë të cilën e ka bërë në Gjykatën themelore në Prishtinë, propozimin e ankesës për sigurimin e pronave të banorëve. Avokati ka kërkuar një ekspertizë nga Komisioni të cilën e cakton Gjykata dhe Gjykata është në proces të formimit të Komisionit. Avokati ka kërkuar që në atë Komision me qenë edhe ne pjesëmarrës, kështu që deri në fund të muajit të ardhshëm nuk ka diçka më shumë.

Sami Ahmeti – Një diçka çka unë mund të kërkoj falje është se nuk është unë që kam mund me marrë pjesë në secilin prej takimeve, por kjo nuk do të thotë se na ka ndalë mundësinë me u mundue sepse kemi marrë zotim serioz pa marrë parasysh orientimit tonë politik lidhur me këtë çështje. Një diçka që z.Jeton e tha më duket se nuk ishte bash e saktë çështja që shpronësimi është bë me kërkesë të KEK-ut, iu ka drejtue Departamentit dhe Ministrisë, por në bazë të Ligjit për shpronësim sepse është ezaurue mundësia e asaj ofertës paraprake, që ka qenë nga Banka Botërore.

Jeton Mjekiqi – Decidiv kërkesa ka qenë e KEK-ut, ndaj Ministrisë që me bë shpronësimin me Ligjin e shpronësimit.

Sami Ahmeti – Ne i morëm vesh 2,3 elemente të mira dhe nuk e di a jemi takue me drejtoreshën e Departamentit të shpronësimit, gjegjësisht të tatimit në pronë dhe qytetarët të cilët kanë përfitue prej këtij shpronësimi e të cilët neve, vazhdimisht na u thoshte se kanë rrezik ato mjete, ose merrni ose leni dhe tjera mundësi nuk do të ketë, na u shpjegue shumë mirë. Do të thotë mundësitë janë që ajo pjesë e mjeteve, çka iu ka dhënë i marrin pa problem dhe krejtë rastet që ndodhin në shpronësim zakonisht që nuk janë të kënaqur shkojnë në Gjykatë dhe Gjykata zakonisht vendos në favor të palëve, e merrë pjesën tjetër në bazë të vendimit të Gjykatës. Ne e kemi thënë edhe herën e kaluar se një vlerësim i tillë nuk jemi që me krijue raste sociale. Përveç takimeve tona, unë iu kam drejtue ministrit me një kërkesë dhe drejtoresha e atij Departamenti na konfirmoi dje që ka pasë takim dje me ministrin për këtë çështje, i cili nuk është i interesuar me krijue raste sociale sepse një familje që i ka 13, ose 14 anëtarë dhe iu jepen

20,000, ose 30,000 euro, ne jemi të vetëdijshëm se nuk ka ku shkon me gjithë ata anëtarë dhe nuk mundet me të zgjidhje të banimit. Sido qoftë, na u dha shpresë se mundësitë janë shumë të mëdha, por prapa atij vendimi është vetëm Gjykata, ajo që mundet me vendosë. E mira është që qytetarët kanë ushtruar dhe janë në procedurë të ushtrimit të padisë, kështu që jemi për atë që secili qytetar i cili konsideron se ka të drejtë të përfitoj të drejtat e tij.

Kryesuesja – Fjalën ia jepë drejtoreshës së shëndetësisë të përgjegjet në pyetjen që e ka marrë në KPF nga z. Sami Ahmeti.

Blerona Shabanaj Mehmeti – Në mbledhjen e KPF-së, është parashtruar një pyetje rreth stomatologjisë. Është e vërtetë, se tash e disa ditë nuk është në funksion me arsyetimin se disa pajisje janë prishë dhe në momentin që ne e kemi marrë kërkesën nga shërbimi i stomatologjisë e kemi inicue në zyren e Prokurimit. Për fat të mirë është lidhë kontrata dje, shumë shpejtë do të furnizohemi dhe do të kryhen shërbimet për të gjithë qytetarët e Komunës së Obiliqit.

Kryesuesja – Po ashtu, kemi edhe një pyetje për drejtorin e Arsimit, për shkollën në Milloshevë, ku kati i parë ka ujë ndërsa kati i dytë dhe i tretë nuk ka ujë dhe janë dikund afër 700 nxënës që frekventojnë në atë shkollë po i shfrytëzojnë vetëm toaletet në katin e parë.

Sahit Zeqiri – Vërtetë, është gjendja ashtu qysh ju e thatë dhe nuk e di prej kujt ka rrjedhë kjo kërkesë, por prej kujt do qoftë është një shqetësim i cili na preokupon edhe neve, si Drejtori si dhe të gjithë qytetarët që atje janë me nxënës dhe mësimitdhënës. Unë këtë rast e di që nga mandati kur kam ardhë dhe është e vërtetë që në sezonën e dimrit ka ujë të mjaftueshëm në 3 katet, ndërsa në sezonën e verës në katin e dytë ka ujë, por jo të mjaftueshëm, e në katin e tretë fare nuk ka ujë. Problemi është në 2 çështje, sipas disa ekspertëve që i kam pyet e para është se janë gypat jo të mjaftueshëm që të furnizohet me kapacitet gjithë lagjja e Milloshevës dhe shkolla. Çështja e dytë është që në këtë sezonë qytetarët rregullisht ujitin nëpër ara dhe sa qëndron kjo unë nuk mundem me ditë, por sipas informatave që i kam më së miri mundem me ditë qytetarët që janë vetë banorë aty, se a qëndron kjo e vërtetë apo jo. Unë kam bisedue edhe me kompaninë e ujës-jellësit dhe ata e kanë pranuar një të vërtetë se gypi nuk është i mjaftueshëm për furnizim të gjithë qytetarëve dhe në këtë rast kemi mungesë të ujit. Është edhe një pus aty, që është hapur para 2 viteve dhe ka pasë ujë të mjaftueshëm, por ai pus sipas mendimit tim muk guxon me u përdorë, do të thotë me hy brenda objektit të shkollës sepse ai ujë nuk është i pijshëm dhe mund të infektohen nxënësit. Ai ujë mund të përdoret vetëm në pjesën e jashtme në oborr. Ne duhet të gjithë edhe një herë edhe me Bordin e Komunës, ti bëjmë kërkesë kompanisë së ujës-jellësit, që ta shikon këtë çështje dhe sigurisht se duhet me të një intervenim, në mënyrë që sa më shpejtë shkolla të ketë ujë të mjaftueshëm.

Ajet Berisha – Ju informoj se jo vetëm tash, por ajo shkollë me vite të tëra, ajo pjesë e Milloshevës, Bakshisë dhe Raskovës për 4,5 muaj të verës, kanë ujë shumë pak dhe për një kohë shumë të shkurtë. Do të thotë se problemi është se furnizimi me ujë nuk bëhet për atë edhe nuk shkon uji. Në katin e parë ka ujë, nuk ka shtypje dhe në katin e dytë nuk shkon hiç uji. Unë po çuditem që paska në katin e parë ujë sepse në shumicën e shtëpive gjatë verës, nuk ka fare ujë. Tash, thojnë po ujitin, nuk po ujitin dhe këta paguhet për këtë punë me dalë e me i nxënë. Problemi këtu është prej fillimit sepse këto 3 fshatra, furnizimin me ujë e kanë shumë të dobët dhe 6 muaj verë kanë problem me ujë. Është edhe një problem tjetër se ujin nga pusët që e kanë është i papijshëm minimalisht Instituti për fshatin Bakshi, këtë e ka konstatue dhe e ka bërë një kyqje të veçantë ndërsa, ujës-jellësi atë kyqje e ka vazhdue edhe në Raskovë dhe i ka lënë 2 fshatrat prapë pa ujë. Prandaj, ato fshatra e kanë problemin e furnizimit, e jo problemin teknik e problem tjera sepse po ujitin edhe në Obiliq, dhe kanë ujë ndërsa atje, 6 muaj verë pothuajse nuk kanë ujë vetëm kur bie shi pëlcasin gypat. Këta, duhet të dalin dhe te konstatojnë, le ti zënë ata që po ujitin sepse duhet me menaxhue pak më mirë.

Samir Ahmeti – Faleminderit prej drejtorit për përgjegjen dhe për sinqeritetin që e pranoi se vërtetë, është ashtu. Unë atë shkollë e frekventoj shpesh, se ndoshta edhe shkollat tjera kanë telashe të tilla, por më e rënda që mua mu duke një zonjë dhe një zotëri që ishin të vjetër që po bënin mirëmbajtjen e shkollës, po

bartnin ujë me kofe për me i pastrue koridoret e shkollës. Kjo, është diçka që nuk duhet me ndodhë dhe unë prej sotit e marrë kogja përgjegjësi që me KUR-in, me bisedue për këtë çështje sepse ky problem duhet të zgjidhet. Gjithashtu, kërkoi edhe prej drejtorit që me na informue nëse, ka probleme të njejta edhe në institucionet tjera publike.

Abdyrrahman Krasniqi – Ju njoftoj se përgjegjëse për furnizim me ujë të pijshëm në Komunën e Obiliqit, është “KUR Prishtina” të njejtën edhe për pastrimin dhe shtrirjen e rrjetit të kanalizimit. Ne si Komunë kemi qenë gjithmonë të involvuar prej vijës së bashkëfinancimit dhe kemi kontribuar në furnizimin e rrjetit me ujë. Në vitin e kaluar e kemi pasë një projekt të përbashkët me “KUR”-in, dhe janë ndërruar pothuajse të gjithë gypat e azbestit në Komunën e Obiliqit dhe tani kemi një furnizim më të mirë me ujë. Ne po planifikojmë me ujësjellësin, që ka qenë edhe kërkesë e tyre, që ndoshta në të ardhmen të vendoset një gyp i veçantë prej Shkabajve, i cili do të furnizonte zonën e Milloshevës, Baimocit, Raskovës e të Bakshisë sepse është një zonë që në vazhdimësi kemi telashe me furnizim, por vetëm gjatë verës sepse jemi në njohuri se banojnë në atë zonë të gjithë qytetarët. Ndoshta, është me rëndësi me nda një informatë për të gjithë banorët që në Komunën e Obiliqit, 2/3 e ujit që furnizohet, por nuk fakturohen, fakturohet vetëm 1/3 e ujit që i bjen nëse, ne furnizohemi me 3 litra ujë faturohet vetëm 1 litër. Ndoshta, është mirë që të jemi më përgjegjës dhe të punojmë edhe me qytetarë që të arrijmë një vetëdijësim që uji i pijshëm nuk është për ujitje, apo pastrimin e ballkonit. Prandaj, duhet të vetëdijësohemi të gjithë së bashku dhe të kemi një kujdes në këtë drejtim.

Labinot Mirena – Kryesuese, këtu, zgjidhja më e mirë është me improvizue ndonjë rezervarë në kulm, bile me pasë ujë nëpër toaleta në secilin kat për 3,4 muaj. Ajo që është e ujësjellësit psh ndoshta bëhet sot, e ndoshta pas 5 vjete. Edhe te çështja e fakturimit, nuk e di sa litra ujë i shpenzojmë, por 12,13 euro unë në banesë paguaj ujë, kështu që është jashtëzakonshisht fakturë e lartë.

Kryesuesja – Drejtori veç qenka i njoftuar dhe e pranoi që ekziston problemi, kështu që besoj se së shpejti do ta gjejnë një zgjidhje. Këtu, u tha se ka puseta jashtë, por ai ujë është i rrezikshëm me u sjellë në shkollë sepse fëmiu si fëmi kur ka etje e pi atë ujë dhe ne e rrezikojmë shëndetin e tyre.

Enver Gashi – Ujësjellësi është obligativ me i furnizue qytetarët, sidomos institucionet e Komunës dhe a e fakturon apo jo është problem i tij. Nëse, ka mundësi Komuna dhe komuniteti me i ndihmue diçka është krejtë në rregullë, por si ujësjellës, si kompani duhet me furnizue. Ndoshta, ka mundësi teknike edhe në shkolla me marrë një pompë shtyese dhe me shtye për katin e dytë dhe të tretë. E dëgjova një element se kur bie shi pëlcastin gypat, do të thotë se ujësjellësi nuk është në nivel. Mendoj se drejtori i DSHPE-së, ose drejtori i DKA-së, duhet me bisedue ose le të furnizon, ose ne si Komunë me ndërmarrë diçka ndaj ujësjellësit me ndërrue një menaxhment ose një padi me ia bë sepse nxënësi nuk bën sot mos me pasë ujë kur është ujësjellësi.

Kryesuesja – Mbetet që drejtorët të merren me këtë çështje dhe me na njoftue



Sami Ahmeti – Unë i kam 2 pyetje, e para u ku kanë mbetë hartat zonale, a janë përfundue dhe a kanë shkue në Ministrinë përgjegjëse sepse dje pata informacion se nuk kanë shkue në Ministri. E dyta, kisha pasë dëshirë me kërkue prej ndonjërit prej këshilltarëve të listës së rrebe me na informue se a distancohen me veprimnet e Nënkrjetarit të tyre, i cili iu ka pri një grupi terrorist që e kanë vra policin shqiptar.

Kryesuesja - Në mbledhjen e radhës besoj se do ti keni përgjegjet për pyetjet e bëra.

Mbledhja përfundoi në ora 12:56'

Bashkëpun. për punë të KK


Azize Zeneli


Kryesuesja e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi